

VENDIM
Nr. 196, datë 13.7.2026

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 91, DATË 2.4.2026, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘DION ENERGJI’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1693/4 prot., datë 9.7.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 91, datë 2.4.2026, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘DION Energji’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 mw’”, i ndryshuar,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 91, datë 2.4.2026, i ndryshuar me vendimin nr. 152, datë 28.5.2026, vendosi të licencojë shoqërinë “Dion Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

- Në pikën 3 të këtij vendimi përcaktohet se shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i operimit.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1693/3 prot., datë 30.6.2026, shoqëria ka depozituar të gjithë praktikën e ndjekur dhe dokumentacionin përkatës, në lidhje me testimin e veprës, sikurse përcaktuar në nenin 10 të kontratës nr. 1980 rep., nr. 1272 kol., datë 6.4.2023, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Me depozitim të dokumentacionit përkatës të testimit të veprës brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 91/2026, i ndryshuar, vlerësohet se kushti i vendosur në pikën 3 të këtij vendimi është plotësuar, ndaj duhet të shfuqizohet.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.

- Në vijim të shfuqizimit të pikës 3, të vendimit nr. 91/2026, i ndryshuar, vlerësohet i nevojshëm edhe ndryshimi i pikës 4 të këtij vendimi, si vijon: “Ky vendim është objekt rishikimi në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 91, datë 2.4.2026, të ndryshuar, si vijon:

a) Pika 3 e vendimi të Bordit nr. 91, datë 2.4.2026, të ndryshuar, shfuqizohet;

b) Pika 4 e vendimi të Bordit nr. 91, datë 2.4.2026, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Dion Energji” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), OSSH sh.a., FTL sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti